



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

**PROGRAMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL
PËR EFEKT MARRJEN E SHKALLËVE TË KUALIFIKIMIT
TË MËSUESVE TË ARSIMIT FILLOR
2016**

1. HYRJJE

Profesioni i mësuesit kërkon përkushtim, përgjegjshmëri dhe standarde të larta pune dhe etike. Mësuesi vepron me ndershmëri dhe integritet të lartë profesional, zotëron përmbajtjen e lëndëve që jep mësim, përditëson dijet dhe aftësitë e tij nëpërmjet trajnimeve dhe kualifikimeve që zhvillon, krijon dhe pasuron vazhdimisht portofolin e tij profesional, përfshihet në procesin e vetëvlerësimit, dokumenton vlerësimet që i bëhen, krijon marrëdhënie korrekte me prindërit në interesin më të mirë të fëmijëve.

Programi i zhvillimit profesional për efekt marrjen e kategorive të kualifikimit të mësuesve të ciklit fillor është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit (IZHA) për t'u ardhur në ndihmë të gjithë mësuesve të këtij cikli në përgatitjen për testimin kombëtar për marrjen e kategorive të kualifikimit si dhe të gjitha Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave Arsimore për të organizuar zhvillimin profesional për të gjithë mësuesit që do të hyjnë në këtë proces.

Programi është zhvilluar duke iu përgjigjur kërkesave që MAS-i ka vendosur për mësuesit që kualifikohen. Programi është hartuar duke mbajtur parasysh fushat kryesore në të cilat testohen njohuritë dhe aftësitë e mësuesve, të tilla si:

- dokumentet zyrtare¹ të cilat kanë të bëjnë me veprimtarinë e mësimdhënie-nxënies në shkollë;
- programet lëndore nga klasa 1-5;
- aspekte të pedagogjisë dhe metodologjisë në ciklin fillor;
- aspekte të etikës dhe komunikimit;
- aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe;
- përmbajtjen shkencore të lëndëve të ciklit fillor, nga klasa 1-5.

2. QËLLIMI I PROGRAMIT

Programi i zhvillimit profesional të mësuesve për efekt kualifikimi synon:

- *të ofrojë* një program orientues për t'u ardhur në ndihmë të gjithë mësuesve të ciklit fillor në arsimin parauniversitar për të realizuar veprimtaritë kualifikuese dhe trajnuese, si dhe DAR/ZA-ve, për të organizuar zhvillimin profesional të mësuesve. Në këtë aspekt programi mund të plotësohet nga DAR/ZA-të përkatëse, sipas kushteve dhe mundësive konkrete;
- *të ofrojë* një program të detyruar, për të cilin mësuesit do të përgatiten, për të përballuar me sukses kërkesat që ka testimi kombëtar.

Programi synon që mësuesi:

- *të njohë* dhe *të zbatojë* legjislacionin arsimor e, në mënyrë të veçantë, të risive më të fundit të reformës arsimore;
- *të zotërojë* kompetencat profesionale të kuadrit mësimdhënës, për të ndikuar drejtpërdrejt në efektivitetin e procesit mësimor, për një mësimdhënie të suksesshme;
- *të përzgjedhë* modelet më të përshtatshme për zhvillimin e mësimit dhe për organizimin e mjedisit të klasës, me qëllim nxitjen e diskutimeve dhe përdorimin e teknikave të larmishme të vlerësimit të nxënësve;
- *të zotërojë* konceptet bazë, ligjësitë shkencore dhe t'i zbatojë me saktësi gjatë mësimdhënies, në përshtatje me specifikat e moshës së nxënësve dhe të klasës ku japin mësim;
- *të zbatojë* rregullat e etikës dhe të komunikimit në punën e tyre në shkollë;

¹ Është fjala për të gjitha dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MAS që zbatohen në shkollë, duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.

- të zbatojë rregullat drejtshkrimore të gjuhës shqipe gjatë procesit të mësimdhënie – nxënies;
- të përdorë teknologjinë duke realizuar sa me shumë orë mësimore në laboratorin e TIK, në klasë me videoprojektor, me simulime, video mësimore etj.;

3. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi është strukturuar sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional, të përmendura më sipër. Për të qenë lehtësisht i përdorshëm, programi është paraqitur sipas një formati të caktuar. Për secilën fushë, përcaktohen:

- ✓ kompetencat profesionale si dhe rezultatet e pritshme për realizimin e këtyre kompetencave;
 - ✓ literatura përkatëse rekomanduese në funksion të përvetësimit të kompetencave të fushës.
- Përshkallëzimi i njohurive dhe aftësive profesionale, të cilat lidhen me kompetencat e secilës fushë të testimit, do ta ndihmojnë mësuesin që të identifikojë çështjet në të cilat duhet të përqendrohet.

FUSHA: DOKUMENTACIONI ZYRTAR	
Kompetenca	Literatura e rekomanduar
<p>Zbatimi me përgjegjshmëri i kërkesave të legjislacionit dhe dokumentacionit shkollor</p>	
<p>Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i ciklit fillor:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • zotëron ligjin për sistemin arsimor parauniversitar dhe dispozitat normative të këtij sistemi; • zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës shkollore; • zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për personelin e shkollës; • zbaton udhëzimet e MAS në funksion të përmirësimit të procesit të mësimdhënie- 	<ul style="list-style-type: none"> • Ligji Nr. 69/2012 për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë. • Urdhri për miratimin e Dispozitave Normative për arsimin parauniversitar (DN), Nr 343, datë 19.08.2013. • Korniza kurrikulare, 2014 • Kurrikula bërthamë klasa KP-5, 2014 • Udhëzim Nr. 25, dt. 17.08.2015 për vitin shkollor 2015-2016 në sistemin arsimor parauniversitar. • Udhëzimi Nr. 44, datë 16.10.2014 “ Për disa

<p>nxënies;</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>zbaton</i> etikën profesionale të mësuesit; • <i>respekton</i> të drejtat dhe liritë e nxënësit; • <i>respekton</i> detyrat, të drejtat dhe liritë e mësuesit; • <i>zbaton</i> rregulloret dhe udhëzimet për zhvillimin profesional të mësuesit. 	<p>shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr. 21 datë 23.07.2010 “Për normat e punës mësimore – edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar”.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Udhëzim Nr. 5 datë 25.02.2013 “Për standardet e mësuesit”. • Udhëzimi Nr. 26 datë 15.08.2015 “Zhvillimin Profesional të Punonjësve Arsimorë”. • Udhëzimi “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve”, 2016. • Udhëzimi Nr.34, dt.11.09.2015 “Për vlerësimin e nxënësve për kurrikulën me kompetenca, në arsimin bazë”. • Karta e performancës së shkollës. • Standardet e shkollës si qendër komunitare.
--	--

FUSHA: PROGRAMET LËNDORE

Kompetenca Zbatimi në mënyrë efektive i programeve lëndore	Literatura e rekomanduar
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i ciklit fillor:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>qëndron</i> i mirëinformuar për të rejtat e reformës kurrikulare, pjesë e të cilës është edhe arsimi fillor; • <i>zbaton</i> programet lëndore duke respektuar të gjitha kërkesat dhe rubrikat e tyre; • <i>përdor</i> me efikasitet, në dobi të prirjeve bashkëkohore, fleksibilitetit të zbatimit të programeve lëndore dhe të integritimit ndërlëndor; • <i>përdor</i> materiale plotësuese kurrikulare që ndihmojnë në përvetësimin e koncepteve dhe aftësive të parashikuara në program; • <i>harton</i> objektiva (rezultate të nxëni) për tema mësimore ose grup temash, kapitujsh, në përputhje me objektivat 	<ul style="list-style-type: none"> • Korniza kurrikulare 2014; • Programet lëndore për klasat 1-5; • Botime dhe materiale ndihmëse në drejtim të hartimit, planifikimit, zbatimit dhe vlerësimit të kurrikulës.

<p>(shkathtësitë) e programit;</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>shpjegon</i> lidhjen program-tekst-plan mësimor vjetor dhe tremujor; • <i>planifikon</i> projekte kurrikulare dhe module mësimore; • <i>përzgjedh</i> mjetet mësimore të nevojshme për të realizuar përmbushjen e objektivave të programeve lëndore; • <i>harton</i> teste sipas kriterëve të caktuar për të vlerësuar njohuritë, shkathtësive, vlerat dhe qëndrimet e nxënësve në lëndë të ndryshme të ciklit fillor; 	
---	--

FUSHA: ASPEKTE TË PEDAGOGJISË DHE METODOLOGJISË NË MËSIMDHËNIE-NXËNIE

Kompetenca I Zotërimi i koncepteve bashkëkohore të edukimit të fëmijëve 6 - 11 vjeç	Literatura e rekomanduar
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i ciklit fillor:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>është</i> njohës i mirë i aspekteve didaktike dhe pedagogjike të mësimdhënies, i stileve të të nxënësve dhe i psikologjisë moshore të nxënësve me të cilët punon; • <i>shfrytëzon</i> literaturën bashkëkohore për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe të të nxënësve; • <i>analizon</i> elementet që i bashkojnë dhe i dallojnë tipet e mësimdhënies me njëra-tjetrën; • <i>menazon</i> situata, sjellje dhe veprime të ndryshme nxënësish; • <i>zotëron</i> aftësitë dhe kompetencat profesionale që i duhen mësuesit të ciklit fillor; • <i>zhvillon</i> mësimdhënie të diferencuar; • <i>dallon</i> vështirësinë në të nxënësve nga aftësia e kufizuar; • <i>harton</i> plane edukative individuale – PEI-n; • <i>krijon</i> klimë të përshtatshme, motivuese dhe të kënaqshme për nxënësit; 	<p>Literaturë që ka në fokus aspekte pedagogjike të punës së mësuesit me nxënësit.</p>

<ul style="list-style-type: none"> • <i>planifikon</i> orë mësimore duke u bazuar në mësimdhënien me në qendër nxënësin; • <i>prezanton</i> materiale didaktike duke përdorur programet më të njohura kompjuterike; 	
Kompetenca II Përdorimi i metodave ndërvepruese dhe i formave të ndryshme të punës me nxënësit e kësaj moshe, realizimi i integritit ndërlëndor	Literaturë e rekomanduar
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i ciklit fillor:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>motivon</i> nxënësit në forma e mënyra efektive; • <i>zbaton</i> metodat ndërvepruese të mësimdhënies në përshtatje me lëndën, temën e mësimit dhe me moshën e nxënësve; • <i>planifikon</i> veprimtari që nxisin të menduarit kritik e krijues dhe problemzgjidhës të nxënësve; • <i>krijon</i> klimë të përshtatshme, motivuese dhe të kënaqshme për nxënësit; • <i>planifikon</i> orë mësimore duke u bazuar në mësimdhënien me në qendër nxënësin; • <i>përdor</i> metoda e teknika që nxisin zhvillimin e të menduarit kritik të nxënësve; • <i>përdor</i> metoda e teknika që sigurojnë barazinë dhe gjithëpërfshirjen; 	<ul style="list-style-type: none"> • Literaturë që ka në fokus metodat e mësimdhënies ndërvepruese, planifikimin e punës me fëmijët me aftësi të kufizuar, hartimin e planit edukativ individual, disiplinimin pozitiv të sjelljes së nxënësve në klasë etj.
Kompetenca III Përdorimi i instrumenteve të ndryshme të vëzhgimit dhe vlerësimit të nxënësve	Literaturë e rekomanduar
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i ciklit fillor:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>përdor</i> mënyra e strategji të ndryshme të dokumentimit, vëzhgimit dhe vlerësimit të nxënësve; • <i>vëzhgon</i> dhe vlerëson me përshkrim ecurinë dhe përparimin e nxënësit, duke përdorur instrumente të 	<ul style="list-style-type: none"> • Udhëzimi Nr.34, dt.11.09.2015 “Për vlerësimin e nxënësve për kurrikulën me kompetenca, në arsimin bazë”. • Korniza e vlerësimit të nxënësit në arsimin parauniversitar,

ndryshme; <ul style="list-style-type: none"> • <i>dokumenton</i> detyra e punime të nxënësve që dëshmojnë përparimin dhe interesin e tyre për shkollën dhe komunitetin përreth; • <i>punon</i> me prindërit për përmirësimin e përparimit të nxënësit. 	IZHA, 2015
---	------------

FUSHA: ASPEKTE TË ETIKËS DHE KOMUNIKIMIT

Kompetenca	Literatura e rekomanduar
Zbatimi i rregullave të etikës dhe komunikimit si elemente të domosdoshme në të gjithë punën e mësuesit	
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i ciklit fillor:</i> <ul style="list-style-type: none"> • <i>njeh</i> rregullat e etikës dhe sjelljes që duhen respektuar në marrëdhënie me drejtuesit e institucionit arsimor, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin; • <i>sillet</i> në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor. 	<ul style="list-style-type: none"> • Kodi i Etikës së Mësuesve në Arsimin Parauniversitar Publik dhe Privat, 30.11.2013 • Literaturë dhe materiale burimore që trajtojnë çështje të etikës dhe të komunikimit.

FUSHA: ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE

Kompetenca	Literatura e rekomanduar
Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe	
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i ciklit fillor:</i> <ul style="list-style-type: none"> • <i>zbaton</i> rregullat e drejtshkrimit të standardit të gjuhës shqipe, në të folur, në të lexuar dhe në të shkruar; • <i>zbaton</i> rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe në çdo veprimtarive në institucionin arsimor. 	<ul style="list-style-type: none"> • Drejtshkrimi i gjuhës shqipe

FUSHA: PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËVE TË CIKLIT FILLOR

<p align="center">Kompetenca</p> <p align="center">Respektimi i rigorozitetit shkencor në mësimdhënien e lëndëve të ciklit fillor</p>	<p align="center">Literatura e rekomanduar</p>
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i ciklit fillor:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>zotëron</i> konceptet shkencore, dukuritë, ligjësitë në nivel shkencor dhe didaktik; • <i>transmeton</i> konceptet shkencore, dukuritë, ligjësitë dhe rregullat në përshtatje me moshën dhe të nxënë të nxënësve; • <i>zotëron</i> njohuritë, aftësitë dhe shprehjet që fitojnë nxënësit nga klasa 1-5 për çdo program lëndor; • <i>planifikon</i> sipas vështirësive tipike që hasin nxënësit gjatë procesit mësimor; • <i>përshtat</i> programet lëndore për nxënësit që paraqesin vështirësi në të nxënë ose që janë me aftësi të kufizuar. 	<ul style="list-style-type: none"> • Të gjitha programet lëndore që përmban Plani mësimor nga klasa 1-5; • Tekstet shkollore nga klasa 1-5; • Botime të ndryshme në ndihmë të mësuesve dhe nxënësve.